



### Shënjimi i Ditës botërore të lirisë së medias

Nën moton „Gazetaria nën rrethimin dixhital“ është motoja me të cilën shënohet dita Botërore e lirisë së mediave e cila nxjerr në pah ndikimin e erës dixhitale mbi lirinë e shprehjes, siguria e gazetarëve, qasja në informacion dhe personalitet. Dita e sotme është një mundësi për riafirmimin e parimeve themelore të medias së lirë, për të vlerësuar shkallën e respektimit të saj dhe për të nderuar gazetarët të cilët humbën jetën gjatë kryerjes së detyrës profesionale. Shoqëria demokratike nuk mund të funksionojë pa lirinë e fjalës, mediave të pavarura dhe kritike prandaj të gjithë pa përjashtim duhet të bëjnë përpjekje për të siguruar një mjedis të sigurt për punën e gazetarëve dhe qasje në informacion. Sipas raportit të fundit të Reporterëve pa principe, para nesh qëndrojnë ende sfida të shumta. Agjencia, si dhe më parë, do të vazhdojë të veprojë në mënyrë proaktive për rritjen e ndërgjegjësimit të rolit të mediave dhe domosdoshmërinë për t'u mundësuar një punë pa pengesa.

### NJOFTIME PËR PUBLIKUN

Agjencia e demantoi informatën e cila nga ana e disa mediave ishte shpallur informacion i gabuar se Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale do të mbulojë 50% të kompensimit për televizionet lokale dhe rajonale për vitin 2022. Agjencia, në fund të vitit të kaluar, në pajtueshmëri me mundësitë e saja financiare vendosi të zvogëlojë tarifën e licencës për transmetim televiziv dhe radiotransmetim për vitin 2022, për 50%. Pasi i'u drejtua Shoqatës së stacioneve TV rajonale dhe lokale – Medium Objektiv, Agjencia sërisht diskutoi për vështirësitë financiare të transmetuesve lokal dhe rajonal dhe i dha mbështetje kërkesës së tyre. Qeveria të sigurojë mjete financiare shtesë për të mbuluar koston e taksës së licencës për transmetim për vitin 2022 në vlerë prej 50%, nëse është e mundur. Për të informuar publikun siç duhet, dhe për të mos ardhur në keqkuptim transmetuesit, ju lutemi të shpallni korrigjimin.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dënon thirrjen e gazetares „Dua të them“ në bisedë zyrtare policore për tekstin e shpallur dhe theksoi se veprime të tilla kërcënojnë lirinë e medias. Apsolutisht është e papranueshme të thirren gazetarë në biseda informative për shkrime të shpallura me interes publik, pasi mund të interpretohen si një përpjekje për frikësim, e cila nga ana tjetër kontribuon në shfaqjen e autocensurës. Raste të tilla kanë ndikim negativ në lirinë e informimit. Agjencia përkujton se kushdo që mendon se medium i caktuar i ka shkelur reputacionin dhe nderin duke shpallur të pavërteta, të paverifikuar ose informacione të pasakta, ka të drejtën të kërkojë nga media të shpallë demant, përgjigje dhe korrigjim, ose të dërgojë parashtrës drejtuar organeve vetërregullatore për mediat.

Në lidhje me thirrjen për bisedë informative të redaktorës së TV Telma nga ana e MPB-ës për lajm që nuk është transmetuar në programin televiziv, Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, njofton se veprimet e tilla mund negativisht të reflektojnë në lirinë e medias. Gazetarët dhe punëtorët e tjerë të medimeve nuk duhet të thiren pa bazë në biseda zyrtare në polici duke patur parasysh se kanë efekt frikësues dhe në të ardhmen mund të çojnë në vetëcenzurim. Veprimet e tilla të organeve hulumtuese ndaj puntorëve mediatik paraqesin shtypje ndaj mediave dhe lirinë e punës së tyre.



## NEWSLETTER

### Mbikëqyrja e transmetueseve, mediave të shkruara dhe operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

#### Transmetuesit

Me qëllim të konstatimit nëse është vepruar ndaj masës së vërejtjes publike për mosmarrëveshje të ndryshme ligjore, Agjencia ka kryer mbikëqyrje programore kontrolluese kundrejt TV Due nga Gostivari. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas vendimeve për marrjen e vërejtjes publike, përkatësisht në programin e transmetuar më 20.04.2022 nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar fillimisht si vepra audio apo audiovizuale maqedonase, as në të paktën gjysma e minimumit ligjor në një periudhë prej orës 7:00 deri në orën 19:00.

Agjencia ka kryer mbikëqyrje programore kontrolluese në TV Sitel për të konstatuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas vendimit për marrjen e masës së vërejtjes publike, të dërguar për mos respektim të detyrimit për ndalimin e komunikimeve të fshehta audiovizive komerciale. Nga mbikëqyrja rezultoi se TV Sitel nuk ka vepruar sipas masës me vërtje publike, respektivisht në programin e datës 26 prill 2022, në emisionin informativ-argëtues “Unë e dua Maqedoninë”, ka transmetuar komunikim të fshehtë komercial audiovizual të enëve të gatimit të shitura nga kompania “Komodita Home”.

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative mbi punën e 108 radiodifuzerëve për të konstatuar nëse ndonjëri nga radiodifuzerët ka ndryshuar strukturën e pronësisë pa e njoftuar më parë Agjencinë dhe para se të miratohet nga Agjencia. Nga mbikëqyrja e kryer është konstatuar se 108 radiodifuzerët kanë vepruar në përputhje me detyrimin ligjor.

Agjencia ka kryer mbikëqyrje programore kontrolluese kundrejt TV Kanal 5 për të konstatuar nëse radiodifuzeri ka vepruar sipas vendimit për marrjen e masës së vërejtjes publike, dërguar për mos respektim të detyrimit për komunikime të fshehta komerciale audiovizive. Nga mbikëqyrja rezultoi se radiodifuzeri ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor.

Me qëllim që të përcaktohet nëse ka kanë vepruar sipas masës së vërejtjes publike dërguar për detyrimet pjesëmarrje në reklama dhe teleshopping të personave të caktuar, Agjencia ka kryer mbikëqyrje programore kontrolluese kundrejt TV Kanal 5 dhe TV Sitel. Nga mbikëqyrja rezultoi se radiodifuzeri ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale sipas detyrës zyrtare ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore kundrejt punës së TV Kanal 5 për të konstatuar nëse është hequr shkelja e nenit 55 paragrafët 6 dhe 7 të LSHMAAV. Mbikëqyrja e jashtëzakonshme konkludoi se TV Kanal 5 në programin e transmetuar më 21 dhe 26 prill 2022, në edicionet e emisionit argëtues-dokumentar “Gjella”, dhe në emisionin informativ tematik të specializuar për shëndetin “Në shtëpi me ...”, produktet e vendosura, të përfshira drejtpërdrejt në veprimet/skenarët e emisioneve, promovohen veçanërisht përmes mbitheksimit vizual dhe verbal, dhe në edicionet e talk show “Sezoni Vip”, i transmetuar më 26 Prill 2022, produkti i plasuar është i mbitheksuar vizualisht.

Për obligimet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës në programet, emetimi i radio programit më së paku 18 orë në ditë dhe emetimi përqindjes me vet-dëshirë i përqindjes së paraqitur muzikë maqedonase është kryer mbikëqyrje e rregullt programore kundrejt radiove Jon, Metropolis, Antena 5 dhe Kanal 77. Nga mbikëqyrja rezultoi se radiodifuzeri ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor.

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale realizoi mbikëqyrje kontrolluese kundrejt televizionit TV Gurra, për të verifikuar nëse radiodifuzeri ka vepruar konform Vendimit për marrjen e masës së vërejtjes publike, dërguar përshkak mos respektimin e obligimit për emetimi 30% të programit më së paku në ditë burimisht maqedonase të prodhuara si audio dhe audiovizuale. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se programi i emetuar më 9 maj 2022 TV Gurra nuk ka emetuar 30% të programit më së paku në ditë burimisht maqedonase të prodhuara si audio dhe audiovizuale, dh gjashtu nuk ka e ka respektuar minimumin nga ligji në periudhë prej 7:00 deri në ora 19:00.

Për obligimet që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës në programet, emetimi i radio programit më së paku 18 orë në ditë dhe emetimi përqindjes me vet-dëshirë i përqindjes së paraqitur muzikë maqedonase është kryer mbikëqyrje e rregullt programore kundrejt radiove Jon, Metropolis, Antena 5 dhe Kanal 77. Nga mbikëqyrja rezultoi se radiodifuzeri ka vepruar në përputhje me detyrimin ligjor.

Agjencia ka kryer mbikëqyrje administrative kundrejt TV Gurra për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas vendimit për dhënie vërejtjeje publike, drejtuar për mosdhënie të informacionit që duhet të jetë në dispozicion të përdoruesve. Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se TV Gurra në programin e transmetuar më 9 maj 2022 nuk ka dhënë informacionin që duhet të vihej në dispozicion të përdoruesve.



## NEWSLETTER

### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Për obligimet për sipas së cilave operatorët e RRPKE janë të obliguar që në pakon e programore të cilin e riemetojnë detyrimisht dhe pa pagesë ti përmbajnë serviset programore të servisit radiodifuziv publik, regjistrimi i pakove programore në Agjenci dhe titërimi i programeve të cilat i riemetojnë operatorët, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore mbi operatorët Multimedija Network L nga Gostivari dhe Skupi Kable nga Shkupi. Nga mbikëqyrja rezultoi se operatori Skupi Kable, i cili sipas njoftimit të Agjencisë mund të operojë në komunën e Haraçinës dhe Shkupit, më 5 maj 2022 ka ritransmetuar për shfrytëzuesit e tij shërbimin programor "IN TV" i cili nuk mbulohet me certifikatën për regjistrimin e shërbimeve programore të lëshuara nga agjencia.

Për obligimet që kanë të bëjnë me regjistrimin e serviseve programore në Agjenci dhe titërimin e programeve të cilat i reemetojnë operatorët, është kryer mbikëqyrje e rregullt programore kundrejt operatorit Antena AS KTV nga Kërçova. Me mbikëqyrjen u konstatua se operatori Antena AS KTV më 20 maj 2022 për shfrytëzuesit e vetë i ka reemituar servisin programor „Russia Today Documentary“ i cili nuk është përfshirë me vërtetimin për regjistrim të serviseve programore lëshuar nga Agjencia.

Kundrejt operatorit të rrjetit publik të komunikimit elektronik Skupi Kable nga Skupi, Agjencia realizoi mbikëqarje kontrolluese programore për të verifikuar nëse ka vepruar sipas masës vërejtje publike, dërguar përshkak reemetimit të serviseve programore të cilët nuk janë të regjistruar në Agjenci. Me mbikëqyrjen u konstatua se operatori ka vepruar sipas vërejtjes paraprahe.

### Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë në seancën e 18-të të mbajtur më 16 maj 2022, në bazë të konstatimeve të mbikëqyrjes së jashtëzakonshme të programit sipas detyrës zyrtare, miratoi vendim për marrjen e vërejtjes publike për Televizionin G-TV nga Gostivari, për shkak të shkeljes së nenit 64 paragrafi 1 i nga LSHMAAV, respektivisht më 11 prill 2022, filmi vizatimor "Pink Panter Pinkozoic Era" u transmetua fillimisht në anglisht pa ofruar përkthim në shqip, maqedonisht ose turqisht, gjegjësisht në gjuhët në të cilat media transmeton program në përputhje me licencën.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 20-të të mbajtur më 20 maj 2022 në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e realizuar solli vendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për TV Iris nga Shtipi. Vërejtja publike ju shqiptua përshkak të mos përmbushjes së obligimit nga neni 15 paragrafi 5 i Lligji për media, respektivisht mos dorëzimin e raportit me shkrim në Agjenci për realizimin e obligimeve të përcaktuar në lejen për transmetim televiziv.

Këshilli i Agjencisë në seancën e 17-të të mbajtur më 9 maj 2022, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja e realizuar ku u konstatua mosrespektimi i obligimit për regjistrimin e serviseve programore të cilin Skupi Kable e ka reemituar për shfrytëzuesit e tij, mori solli vendim për vërejtje publike dhe për çkyejen e TV kanaleve diskutabile.

Në seancën e 21 të mbajtur me datë 27 maj 2022, Këshilli i Agjencisë i shqiptoi masë vërejtje publike operatorit Antena AS KTV nga Kërçova përshkak të reemetimit të servisit programor „Russia Today Documentary“ i cili nuk ishte përfshir me vërtetim për regjistrim të servisit programor të lëshuar nga Agjencia.

